

VENDIM
Nr. 503, datë 6.7.2016

**PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN E FONDIT OPERATIV TË POLICISË
USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 13/2015, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Policia Ushtarake përdor fondin operativ, që i vihet në dispozicion për realizimin e veprimtarive specifike, brenda fondeve të miratuara në buxhetin vjetor për Ministrinë e Mbrojtjes.
2. Fondi operativ i Policisë Ushtarake përdoret për:
 - a) shpenzime për sigurimin e informacionit dhe mbështetjen e veprimtarisë operative;
 - b) shpenzime për marrje me qira të objekteve dhe të mjeteve në funksion të veprimtarive operative;
 - c) shpenzime për veprimtarinë procedurale penale për oficerin dhe agjentin e Policisë Gjyqësore ose personin e autorizuar prej tyre, gjatë kryerjes së operacioneve, ku përdoren metoda të posaçme hetimi (përgjime, veprime simuluese dhe infiltrime).
3. Vlera e fondit operativ është deri në 2% të vlerës së buxhetit vjetor të Policisë Ushtarake.
4. Kontrolli mbi përdorimin e fondit operativ ushtrohet, jo më pak se një herë në vit, nga ministri i Mbrojtjes ose personat e autorizuar prej tij, të cilët duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie. Kontrolli ushtrohet duke respektuar legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.
5. Ministri i Mbrojtjes nxjerr udhëzim për përcaktimin e procedurave e të dokumentacionit të nevojshëm për përdorimin e këtij fondi.
6. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi